



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 29/4 Prot  
*Lutemi referoni këtë numër në përgjigje*

Tiranë, më 29/04 2021

**VENDIM**

Nr.22, date 29 /04/2021

**PËR**

**RAPORTIN VJETOR TE SHFRYTEZIMIT TE DIGES SE MURDHARIT TE  
ADMINISTRUAR NGA KOMPANIA "HYDROENERGY" SHPK**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave" Neni 32, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 29.04.2021 mori në shqyrtim Raportin Vjetor të shfrytëzimit të diges së Murdharit të administruara nga Kompania "HYDROENERGY" shpk. Bazuar në Raportin e paraqitur, gjendjen aktuale të digave perkates, Rreziqeve të mundshme me të mëdha gjatë shfrytëzimit të diges si dhe kërkesave të legjislacionit të mesiperm, KKDM

**VENDOSI:**

1- Ti kërkojë Kompanisë HYDROENERGY shpk

- Plotësimin dhe dorëzimin pranë KKDM të projektit të plote të punimeve sipas faktit për Digen e Murdharit dhe elementeve të saj të shoqëruar me vizatimet sipas faktit, analizat e materialeve që janë hedhur, volumet e punimeve, etj
- Instalimin e sistemeve të Monitorimit dhe sistemit të Alarmit në digë brenda vitit 2021 sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe Udhezimeve të KKDM
- Përgatitjen e Planeve të Gadishmërisë në rastet e emergjencave civile dhe hartat e përmbajtjeve në pjesën e poshtme të diges sipas legjislacionit të mesiperm dhe Udhezimeve të KKDM brenda muajit Nendor 2021.
- Kryerjen e matjeve të depozitimeve të materialeve të ngurta në rezervuarin e krijuar sipas kërkesave të VKM Nr.147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe Dambave", neni 30

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

